



DIP

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

Nr. 19681, prot.,

Vlorë, më 05.12.2024

## PROJEKTVENDIM

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ 2024

**PËR MIRATIMIN E VLERAVE TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË DHE TË SUBVENCIONIT MAKSIMAL TË QIRASË QË PËRFITOJNË FAMILJET PA TË ARDHURA**

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1/a, dhe 1.1/5, neni 30 pika 7, neni 54/dh, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, kreu V neni 33, 34, 35, 38, 39, të VKM Nr.362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, të VKM Nr.459 datë 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufitimit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, të VKM Nr.384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, si dhe Vendimin e Komisionit të Strehimit të Bashkisë Vlorë;

**V E N D O S I**

- I. Të miratojë vlerat e qirasë mesatare në treg të lirë dhe të subvencionit maksimal të qirasë që përfitojnë familjet pa të ardhura sipas strukturave takuese të apartamenteve:

Garsonierë	15.000 lekë/muaj
(1+1)	20.000 lekë/muaj
(2+1)	25.000 lekë/muaj
(3+1)	30.000 lekë/muaj
- II. Familjet përfituese do të miratohen mbas paraqitjes së kërkesës dhe të dokumentacionit pranë Bashkisë Vlorë, si dhe të kryerjes së procedurave të vlerësimit dhe të verifikimit të kushteve të banimit në terren nga strukturat përkatëse.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës & Investimeve Publike, Rajonet dhe Njësitë Administrative, Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Buxhetit dhe Kontabilitetit pranë Bashkisë Vlorë.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015, neni 55, paragrafi 6.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

## RELACION

Për projekt-vendimin

### **PËR MIRATIMIN E VLERAVE TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË DHE TË SUBVENCIONIT MAKSIMAL TË QIRASË QË PËRFITOJNË FAMILJET PA TË ARDHURA**

Në zbatim të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 "Për strehimin social", të ndryshuar kreu V neni 33, 34, 35, 38, 39, dhe të VKM Nr.362, datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", informojmë se:

Subvencioni i qirasë është një instrument i programit të banesave sociale me qira që ndihmon individët/familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë së tregut të lirë.

Masa e subvencionit të qirasë është në varësi të të ardhurave të familjes. Për familjet pa të ardhura, sipas kuptimit të të ardhurave të këtij ligji, si psh familje që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, pavarësisht nëse nuk e kanë përfituar atë, **masa e subvencionit të qirasë mund të jetë deri në 100% të vlerës së qirasë mesatare të banesave në tregun e lirë të njësisë së vetëqeverisjes vendore.**

**Vlera maksimale e subvencionit të qirasë përcaktohet çdo vit bazuar në të dhënat e vitit të mëparshëm dhe miratohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.**

*Sipas nenit 2 pika 36, të ligjit nr.22/2018 datë 3.5.2018, "Qira mesatare" është mesatarja e ofertave të qirave, të marra gjatë një viti, në tregun e lirë.*

*Qira reale, është vlera aktuale e çmimit të qirasë së një banese të caktuar në tregun e lirë.*

Në funksion të dhënies së subvencionit të qirasë nga Bashkia Vlorë për vitin 2025 për familjet/individët e pastrehë që jetojnë me qira në tregun e lirë dhe nuk përballojnë dot pagesat e qirasë, nevojitet të përcaktohen qiratë mesatare të tregut të lirë për vitin 2024. Për këtë, kryesisht nga struktura që mbulon çështjet e strehimit, por edhe në bashkëpunim me përfaqësuesit e rajoneve janë kryer veprimet dhe procedurat si vijon:

1. Janë kryer vëzhgime, sondazhe dhe vlerësime në një numër të konsiderueshëm të apartamenteve, në lagjet, rrugët dhe blloqet e banimit, për të cilët ka informacion se jepen me qira.
2. Kanë komunikuar me agjensi imobiliare që operojnë në qytetin e Vlorës dhe disponojnë informacion të sigurt lidhur me transaksionet e pronave dhe tregun e qirave. Janë vizituar faqet e tyre zyrtare, ose janë kontaktuar direct për më shumë informacion, si Deas Real Estate, etj.



3. Kanë gjetur platforma online që ofrojnë informacione dhe mundësi për të dhënë dhe marrë me qira apartamente dhe banesa, si Imobiliare.al, Merr jep.al

4. Kanë marrë të dhëna nga zyrat noteriale, të dhëna mbi çmimet e qirasë së banesave të kontratave të depozituara për efekt të përfitimit të subvencionit të qirasë në Bashkinë Vlorë nga familje dhe individë.

5. Kanë identifikuar raste në nevojë të familjeve dhe individëve të pastrehë që jetojnë në banesa të marra me qira në tregun e lirë, etj.

Sa më sipër:

1. Është përjashtuar zona Skelë-Uji i Ftohtë, apartamentet përgjatë shëtitores Lungomare, në dhënien me qira për efekt të përfitimit të subvencionit të qirasë, ku apartamentet jepen me qira në funksion të pushimeve dhe turizmit, me qira ditore, me qira afatshkurtër dhe në monedhën euro.

2. Janë përjashtuar rastet e dhënies me qira me afate të shkurtëra, më pak se 1 vit.

3. Janë përjashtuar rastet e dhënies me qira të banesave me kushte të papërshtatshme banimi, nga pikëpamja fizike dhe higjieno-sanitare

4. Janë përjashtuar rastet e dhënies me qira të banesave pa praninë, apo prokurën e përfaqësimit të pronarëve të banesës.

Nga vëzhgimet në terren kemi konstatuar se, qiratë e banesave në qytetin e Vlorës variojnë në varësi të disa faktorëve si, vendndodhja, madhësia e apartamentit, afërsia me detin, gjendja dhe pajisjet që ofron. Çmimet mund të ndryshojnë dhe sipas sezonit me rritje të konsiderueshme gjatë sezonit turistik veror.

Gjatë viteve dhe muajve të fundit, qiratë e banesave në Vlorë kanë pësuar një rritje të ndjeshme veçanërisht në zonat bregdetare si Lungomare, ku çmimet janë të larta. Aktualisht, qiratë në këto zona variojnë nga 500 deri në 1500 euro në muaj, në varësi të madhësisë dhe afërsisë me detin. Kjo rritje është nxitur kryesisht nga kërkesa e lartë, veçanërisht nga të huajt që janë të interesuar për të jetuar, apo investuar në qytet. Përveç kësaj shtrenjtimi i çmimeve të ndërtimit dhe dyfishimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë kanë ndikuar gjithashtu në rritjen e kostos dhe të qirave në Vlorë.

Në rastin e familjeve që jetojnë dhe punojnë në qytetin e Vlorës dhe nuk disponojnë banesa në pronësi, të jetuarit në banesë të marrë me qira përbën një sfidë, në jo pak raste, të papërballueshme.

Përgjithësisht, tregu i qirasë së banesave është i lidhur ngushtësisht me të ardhurat e familjeve/individëve, që kryesisht vijnë nga punësimi, rrugët informale, dërgesat nga jashtë, etj. Në rastin e grupeve të familjeve me të ardhura shumë të ulëta, apo pa të ardhura, ku bëjnë pjesë edhe grupet vulnerabël, rritja e çmimeve dhe luhatjet e tregut janë tërësisht të papërballueshme, të cilët drejtohen tek bashkia për të mbuluar totalisht pagesat e tregut të lirë.

Ata detyrohen të gjejnë në treg banesa me kushte të papërshtatshme me çmim të lirë, ose të marrin banesa më të mira, ku kërkohet një subvencionim maksimal nga bashkia. Nga vëzhgimet në terren ka rezultuar se, çmimet e qirasë së apartamenteve varen nga kushtet që ofron apartamenti në përgjithësi, por ka raste të mospërputhjes së çmimit që pritët të marrë qiramarrësi nga apartamenti dhe kërkesës nga qiradhënësi.

Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë i mbledhur në datën 12.11.2024 analizozi të gjitha rezultatet e mbledhura nga vëzhgimet dhe sondazhet në terren të grupeve të punës, lidhur me qiratë e tregut të lirë sipas rajoneve, të dhënat e mbledhura nga zyrat noteriale për kontratat e dhënies me qira, të dhënat e mbledhura nga agjensitë imobiliare dhe platformat online. Komisioni konkludoi se në të gjithë qytetin, qiratë mesatare për vitin 2024 dhe si rrjedhojë, subvencioni maksimal i qirasë në tregun e lirë për vitin pasardhës të jenë;

Garsonierë	15.000 lekë/muaj
(1+1)	20.000 lekë/muaj
(2+1)	25.000 lekë/muaj
(3+1)	30.000 lekë/muaj.

Në përcaktimin e subvencionit të qirasë do të merret qiraja reale sipas kontratës, por jo më e madhe se qiraja mesatare, Qmes.

Familjet përfituese do të miratohen mbas plotësimit, shqyrtimit të dokumentacionit dhe verifikimit të kushteve të banimit në terren. Komisioni i Strehimit do të përzgjedhë familjet/individët përfitues. Lista e përfituesëve do t'i paraqitet për miratim Këshillit të Bashkisë Vlorë.

Sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë këtë projekt-vendim, me qëllim plotësimin e kërkesës ligjore për miratimin e vlerave të subvencionit maksimal të qirave të tregut të lirë, që janë të barabarta me vlerat mesatare të qirasë së tregut të lirë, me qëllim plotësimin e kërkesave të qytetarëve në nevojë që i drejtohen bashkisë për mbështetje.

Drejtor

Z. Selmani





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

KOMISIONI I STREHIMIT

Nr. 19681 Prot.,

Vlorë, më 05.12 .2024

MIRATOHET  
KRYETAR

Ermal Dredha

VENDIM

Nr. \_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

**PËR MIRATIMIN E VLERAVE TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË DHE TË SUBVENCIONIT MAKSIMAL TË QIRASË QË PËRFITOJNË FAMILJET PA TË ARDHURË**



Në rreshtetjete të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" nën 8 pika 2, neni 9 pika 1.1/a, dhe 1.1/5, neni 53 pika 7, neni 54/dh, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 "Për strehimin social", kreu V neni 33, 34, 35, 38, 39, të VKM Nr.362, datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë", nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", të VKM Nr.384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afatëve e të procedurave të miratimit nga tregu i vetëqeverisjes vendore", Komisioni i strehimit të Bashkisë Vlorë i mbledhur në datën 12.11.2024, pasi shqyrtoi të dhënat e nxjerra nga verifikimi në terren i ofertave, me të cilat janë dhënë me qira banesat në tregun e lirë gjatë vitit 2024 në qytetin e Vlorës;

KONSTATOISE

1. Nga ana e strukturës që mbulon çështjet e strehimit në bashkëpunim me 5 rajone administrative përgjatë vitit 2024, krahës procesit të verifikimit të kontratave të qirasë për familjet që kanë aplikuar për të përfituar subvencionin e qirasë në treg të lirë pranë Bashkisë Vlorë, janë kryer sondazhe dhe vlerësime për çmimet e qirasë së banesave edhe në gjerë, në bllokun, apo zonën e banimit. Në këtë mënyrë është marrë informacion për të gjithë qytetin e Vlorës. lidhur me ofertat për dhënie me qira të apartamenteve garsonierë, (1+1), (2+1) dhe në raste të veçanta (3+1) në tregun e lirë.
2. Janë marrë të dhëna nga agjensi imobiliare dhe platforma online që ofrojnë informacione dhe mundësi për të marrë me qira apartamente dhe shtëpi.
3. Çmimet e qirasë së banesave të marra nga kontratat noteriale të depozituara nga familjet për efekt të përfitimit të subvencionit të qirasë janë të dhëna të konsiderueshme për tu përdorur në këtë proces.



4. Nga vrojtimit në terren është konstatuar se në tregun e lirë nuk ka një rregullsi të caktuar për marrjen dhe dhënien me qira të banesave. Çmimet për dhënien me qira të apartamenteve për familjet në nevojë kushtëzohen nga disa faktorë, nga vendndodhja e apartamenteve, nga cilësia, nga mobilimi, si edhe nga të ardhurat e familjeve që kërkojnë të strehohen. Në disa raste ka mospërputhje midis çmimit që kërkohet nga qiramarrësi kundrejt çmimit që ofron qiradhënësi.

5. Palët qiradhënëse dhe qiramarrëse shprehin vullnetin përkatës dhe në fund japin dakortësinë për nënshkrimin e akteve të qiradhënies.

6. Çmimet e apartamenteve të dhëna me qira në qytetin e Vlorës për vitin 2024 të marra nga burimet e poshtëshënuara :

- Nga kontratat e qirave të nënshkruara para noterit gjatë vitit 2024, të depozituara nga familjet pranë Bashkisë Vlorë për efekt të përfitimit të subvencionit të qirasë.
- Nga Agjensitë imobiliare si, DES Real Estate
- Nga platformat online si, Merr.jep.al dhe Imobiliare.al
- Nga verifikimet në terren nga struktura që mbulon strehimin në bashkëpunim me rajonet administrative,
- Janë si vijon:

1. Nga kontratat e qirave të nënshkruara para noterit gjatë vitit 2024, të depozituara pranë Bashkisë Vlorë për efekt të përfitimit të subvencionit të qirasë.

-Shtëpi private në Rajonin Nr.1, (2+1) e ndodhur në zonë periferike, 15000 lekë në muaj për një periudhë 5 vjeçare

-shtëpi private në Rajonin Nr.1, (1+1), përballë spitalit rajonal, e ndodhur në rrugë të kategorisë së tretë, 10000 lekë në muaj

-Shtëpi private në Rajonin Nr.1, garsonierë, përballë spitalit rajonal, 15000 lekë në muaj

-apartament (1+1) në Rajonin Nr.2, në rrugë dytësore, 15000 lekë në muaj

-apartament (1+1) i ri, i mobiluar në Rajonin nr.2, 300Euro/muaj

-apartament tip i vjetër, në Rajonin Nr.3, i pamobiluar, i ndodhur në rrugë të kategorisë së dytë, 18000 lekë në muaj

-Shtëpi private garsonierë, në rrugë të kategorisë së dytë, 10000 lekë në muaj

- Shtëpi private në Rajonin Nr.4, në rrugë dytësore, 20000 lekë/muaj

-Apartament garsonierë në Rajonin Nr.4, 12000 lekë/muaj

-Apartament i vjetër në Rajonin Nr.4, (2+1) 20000 lekë në muaj

-Apartament i vjetër në Rajonin nr.5, (1+1), 20000 lekë në muaj

-Shtëpi private në Rajonin nr.5, e ndodhur në bllokun tek ish-fusha e aviacionit , 15000l/m

2. Nga Agjensitë imobiliare si psh., DES Real Estate, për të gjithë qytetin e Vlorës dhe në periudha afatgjata

- Çmimi i apartamenteve me tipologji garsonierë të arëduara varion 180euro deri në 250 euro/muaj

- Çmimi i apartamenteve me tipologji 1+1 i paarëduar varion 200euro deri në 250 euro/muaj

- Çmimi i apartamenteve me tipologji 1+1 i arëduar varion 280euro deri në 350 euro/muaj

- Çmimi i apartamenteve me tipologji 2+1 i paarëduar varion 250euro deri në 330 euro/muaj

- Çmimi i apartamenteve me tipologji 2+1 i arëduar varion 350euro deri në 500 euro/muaj

- Çmimi i apartamenteve me tipologji 3+1 i paarëduar varion 300euro deri në 380 euro/muaj

- Çmimi i apartamenteve me tipologji 3+1 i arreaduar varion 450euro deri në 600 euro/muaj
- Shtëpi private në zonat periferiketë qytetit çmimet variojnë nga 250 Euro pjesërisht të arreaduara në 500 Euro të arreaduara.

3.Nga platformat online Merr.jep.al dhe Imobiliare .al

- Apartament 2+1 i ri, i mobiluar pranë Sheshit të Flamurit, 400 euro/m
- Apartament (1+1), i ri, i mobiluar pranë hotel Partner, 550 euro/muaj
- Apartament 1+1, i ri, i mobiluar pranë Gama Market, 550 euro/muaj
- apartament garsonierë 38 m2 në zonën Skelë-Vlorë, i ri, i mobiluar, 550euro/muaj
- apartament 1+1 në rrugën e Çipajve, 250euro/muaj
- apartament 1+1 tek Bishti Kalldrëmit, 280euro/muaj
- apartament 1+1 tek ish-shtëpia e oficerëve, e mobiluar 350 euro/muaj
- apartament 2+1 në hyrje të Vlorës 300 euro/muaj
- apartament 2+1 pranë Kishës Ortodokse, 400euro/muaj
- apartament pranë shkollës Ali Demi, 2+1, 350euro/muaj
- apartament pranë shkollës Ismail Qemali, 2+1, 300euro/muaj
- apartament pranë bibliotekës Shefqet Musaraj 350euro/muaj
- apartament 2+1 pranë teatrit Petro Marko, 400euro/muaj
- apartament pranë shkollës Drita e Dijes 1+1, 300euro/muaj
- apartament 2+1 pranë Gjykatës së Apelit, 250 euro/muaj
- apartamenti 1+1 tek rruga e Çipajve 350euro/muaj
- apartament 2+1 tek rruga e Çipajve 450euro/muaj
- apartament 2+1 tek karburant Vola, 400euro/muaj

-4. Nga verifikimet në terren nga struktura që mbulon strehimin në bashkëpunim me rajonet administrative,

Nga vrojtimit dhe sondazhet e kryera përgjithësisht në lagjet, rrugët dhe blloqet e banimit, në banesa private, apartamente të vjetër, të rinj, të mobiluar, të pamobiluar, çmimet për dhënien me qira kanë rezultuar si vijon:

- garsonierë 8000-10000-15000-18000-200000, mesatarja rreth 15000 lekë në muaj
- (1+1) 15000-18000-20000-25000-30000, mesatarja rreth 20000 lekë në muaj
- (2+1) 18000-20000-25000-30000-35000, mesatarja rreth 25000 lekë në muaj
- (3+1) 25000-28000-30000-33000-35000, mesatarja rreth 30000 lekë në muaj

Zyrat materiale për nënshkrimin e kontratave të qiradhënies dhe qiramarrjes midis palëve mbështeten në Vendimin Nr.469, datë 3.6.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”, ku në asnjë rast vlera e dhënies me qira të ndërtesës, nuk duhet të jetë më e vogël se vlera minimale e qirasë, e përcaktuar në këtë vendim. Pra, jo më e vogël se 0,3% e çmimit të shitjes së saj, e përcaktuar me Udhëzim të Këshillit të Ministrave. Enti Kombëtar i Banesave në përcaktimin e qirasë së tregut për efekt subvencionit të familjeve, përdor çmimin e qirasë 250 lekë/m<sup>2</sup>.

Të dhënat e mësipërme mbi çmimet e qirasë së banesave në tregun e lirë vënë në dukje vështirësinë dhe pamundësinë që kanë familjet dhe individët e pastrehë që banojnë me qira për të përballuar ofertat e tregut të qirave.

Familjet/individët pa të ardhura, si pasojë e problematikave sociale dhe shëndetësore të një apo disa anëtarëve të tyre, edhe në rastet e përfitimit të subvencionit nga bashkia, e kanë të vështirë gjetjen e banesave me qira me nivelet e qirasë mesatare në fuqi, të miratuara me VKB Nr.75, datë 30.09.2022 ku, Qmes. për apartament me strukturë garsonierë është 10000 lekë në muaj, për (1+1) është 15000 lekë në muaj, për (2+1) është 20000 lekë në muaj, për (3+1) është 25000 lekë në muaj.

Në këto kushte nevojitet rritja e vlerave të qirasë mesatare të tregut të lirë në masën e mesatares aktuale të qirave të tregut për vitin 2024, të mbështetur në vlerësimet dhe përfundimet si më sipër.

Sa më lart, Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë ;

#### VENDOSI

1. Të miratojë qiratë mesatare të tregut të lirë për efekt të subvencionimit të qirasë në tregun e lirë për familjet në nevojë për vitin 2024.
2. Vlerat e qirave mesatare sipas strukturave takuese të apartamenteve që përcaktohen nga normat e strehimit për çdo kategori familjare të jenë:

Garsonierë	15.000 lekë/muaj
(1+1)	20.000 lekë/muaj
(2+1)	25.000 lekë/muaj
(3+1)	30.000 lekë/muaj.

3. Në përcaktimin e subvencionit të qirasë do të merret qiraja reale sipas kontratës, por jo më e madhe se Qmes.
4. Për familjet që përfitojnë subvencionin maksimal, vlera e këtij subvencionit përputhet

100% me vlerat e qirave mesatare si vijon:

Garsonierë	15.000 lekë/muaj
1+1)	20.000 lekë/muaj



(2+1) 25.000 lekë/muaj

(3+1) 30.000 lekë/muaj.

5. Familjet përfituese do të miratohen mbas plotësimit, shqyrtimit të dokumentacionit dhe verifikimit të kushteve të banimit në terren. Komisioni i Strehimit do të përzgjedhë familjet/individët përfitues. Lista e përfituesëve do t'i paraqitet për miratim Këshillit të Bashkisë Vlorë.

6. Sa më sipër të përgatitet project-vendimi , që do të përcillet në Këshillin e Bashkisë Vlorë për miratim.

#### KOMISIONI

1. Irena Toshkallari
2. Zambak Selmani
3. Dorian Demiri
4. Skerdilajd Hunda
5. Orest Ruçaj
6. Manuela Prifti
7. Donald Leskaj
8. Bledar Toja
9. Kanan Shakaj
10. Genard Fegaj
11. Selim Haskoçelaj
12. Birçe Aliraj
13. Drita Mustafai

